

L I G J
Nr.8461, datë 25.2.1999

PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë arsimi i lartë është publik dhe jopublik.

Arsimi i lartë publik garantohet dhe financohet nga shteti, si dhe nga burime të tjera të ligjshme.

Arsimi i lartë publik është laik.

Neni 2

Misioni i arsimit të lartë civil është:

- a) të krijojë, të zhvillojë, të mbrojë e të transmetojë dijet me anën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, të zhvillojë dhe të çojë përpara artet, edukimin fizik dhe sportet;
- b) të formojë specialistë të lartë;
- c) të përgatisë shkencëtarë të rinj.

Arsimi i lartë i strukturave të Forcave të Armatosura, si dhe i strukturave të tjera që kanë statusin e ushtarakut, ka për mision të formojë, të përgatisë e të kualifikojë oficerë dhe specialistë të lartë, të aftë e të përkushtuar në mbrojtjen e Atdheut dhe në zbatimin e detyrave që përcaktohen me ligj.

Arsimi i lartë i policisë ka për mision të formojë, të përgatisë e të kualifikojë specialistë të aftë e të përkushtuar për mbrojtjen dhe sigurinë publike.

Neni 3

Arsimi i lartë civil kryhet në shkollat e larta universitare dhe në shkollat e larta jouniversitare. Shkollat e larta universitare dhe jouniversitare më poshtë do të quhen “shkolla të larta”.

Arsimi i lartë i strukturave të Forcave të Armatosura, atyre të policisë, si dhe i strukturave të tjera që kanë statusin e ushtarakut, kryhet në shkollat e larta përkatëse, të

cilat më poshtë do të quhen “shkolla të larta ushtarake ose të policisë”.

Neni 4

Shkollat e larta dhe shkollat e larta ushtarake ose të policisë janë persona juridikë.

Shkollat e larta drejtohen dhe përfaqësohen nga rektori ose drejtori.

Shkollat e larta ushtarake ose të policisë drejtohen dhe përfaqësohen nga komandanti ose drejtori.

Neni 5

Shkollat e larta universitare janë institucione mësimore-shkencore që kanë për detyrë:

a) të realizojnë arsimimin profesional dhe formimin shkencor, nëpërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor;

b) të kryejnë studime shkencore në fushat që mbulojnë dhe të përgatisin shkencëtarë të rinj.

Shkollat e larta jouniversitare janë institucione mësimore dhe detyrë kryesore kanë përgatitjen e specialistëve me kualifikim të lartë.

Neni 6

Shkollat e larta kanë liri akademike në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. Liria akademike qëndron në respektimin e opinioneve, të ideve e metodave dhe në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijues të mësimdhënies e të kërkimit shkencor, në përputhje me planet dhe programet përkatëse.

Neni 7

Shkollat e larta publike civile janë institucione autonome. Në këtë kuadër:

a. shkolla e lartë zgjedh organet dhe autoritetet e veta drejtuese;

b. personeli i shkollës së lartë ka të drejtë të zgjedhë e të zgjidhet në organet drejtuese të shkollës së lartë në përputhje me statusin e shkollës së lartë;

c. shkolla e lartë përcakton fushat e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor;

ç. shkolla e lartë përzgjedh personelin e vet;

d. buxheti i çdo shkolle të lartë publike është zë më vete në buxhetin për arsimin dhe administrohet prej saj sipas rregullave të përcaktuara me akte ligjore. Buxheti i shkollave të larta ushtarake ose të policisë është zë më vete në buxhetin e ministrisë përkatëse;

dh. shkolla e lartë ka të drejtë të ofrojë shërbime në fushat që kanë lidhje me aspektet e zbatimit praktik të mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe të realizojë të ardhura prej tyre;

e. shkolla e lartë ka të drejtë të lidhë marrëveshje me shkollat e larta të huaja për shkëmbim përvoja dhe për bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor, si dhe për kualifikimin e personelit;

ë. shkolla e lartë ka të drejtë të vendosë marrëdhënie dhe të anëtarësohet në shoqata

ose organizata ndërkombëtare të arsimit të lartë;

f. shkolla e lartë ka të drejtë të bashkëpunojë me subjekte, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë.

Neni 8

(Ndryshuar paragrafi i dytë dhe shtuar paragraf me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Shkollat e larta ushtarake ose të policisë kanë të drejtë të përzgjedhin personelin e tyre mësimdhënës e drejtues, të cilin ia propozojnë për miratim ministrisë përkatëse.

Titullari i shkollave të larta ushtarake emërohet nga Ministri i Mbrojtjes nga radhët e oficerëve madhorë dhe me gradë shkencore, ndërsa titullari i Akademisë së Policisë emërohet sipas ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

Shkolla e lartë ushtarake është institucion arsimor, në varësi të strukturave hierarkike të Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa Akademia e Policisë është institucion arsimor, në varësi të strukturave hierarkike të Ministrisë së Rendit Publik.

Shkollat e larta ushtarake ose të policisë kanë të drejtë të vendosin marrëdhënie me shkollat simotra të huaja për shkëmbim përvoja e bashkëpunim në procesin mësimor-shkencor, në kualifikimin e kuadrit, si dhe të marrin pjesë në shoqata dhe organizata ndërkombëtare, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara ose të miratuara nga ministria përkatëse.

Neni 9

Shteti garanton paprekshmërinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe të territorit të tyre.

Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset akademike bëhet me kërkesën ose me lejen e titullarit të shkollës së lartë. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e titullarit të shkollës së lartë.

Cenimi i paprekshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë ndëshkohet sipas dispozitave ligjore.

Neni 10

Vlerësimi i cilësisë së shkollave të larta dhe akreditimi akademik kryhen nga Agjencia e Akreditimit dhe Këshilli i Akreditimit. Krijimi dhe kompetencat e tyre përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

KREU II

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I SHKOLLAVE TË LARTA

Neni 11

Shkollat e larta universitare përbëhen nga fakultetet. Në raste të veçanta, brenda një shkolle të lartë universitare mund të përfshihet një shkolle e lartë jouniversitare, me strukturë të ngjashme me atë të një fakulteti.

Fakulteti është njësi mësimore-shkencore e shkollës së lartë universitare, që mbulon shkenca me trung të përbashkët.

Fakulteti dhe shkollat e larta jouniversitare përbëhen nga departamente.

Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore e shkollës së lartë universitare dhe njësi bazë mësimore e shkollës së lartë jouniversitare. Objekti i mësimdhënies dhe i kërkimit shkencor të departamentit përfshin disa disiplina të një shkence. Departamenti, si rregull, ndahet në seksione, në të cilat përfshihen disiplinat më të përafërta të një shkence.

Neni 12

Në strukturat e njësive të shkollave të larta përfshihen institutet, qendrat dhe sektorët kërkimorë, laboratorët dhe ateliere mësimore, klinikat, shërbimet, studiot, bibliotekat, qendrat sportive, muzetë, fermat eksperimentale, që funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme përkatëse.

Neni 13

Kursi i studimit është një fushë studimi në shkollën e lartë, në përfundim të të cilit, nga shkolla e lartë pranë së cilës kryhen studimet, lëshohet diplomë. Sipas natyrës akademike, kursi i studimit mund të emërohet “degë” apo “profil”. Profili është nëndegëzim, me një orientim studimi me të ngushtë dhe më specifik se dega.

Kursi i studimit hapet me vendim të senatit të shkollës së lartë, pasi të jetë marrë miratimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për plotësimin e stadardeve të vendosura prej saj. Efektet ekonomike të hapjes së kursit të ri përballohen nga shkolla e lartë. Shteti, në buxhetin që i cakton shkollës së lartë publike, merr parasysh ekzistencën e kursit të ri vetëm pasi ta ketë njohur nëpërmjet procedurave të akreditimit.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës miraton emërtimin e diplomave që lëshojnë shkollat e larta për ato kurse studimi të njohura nëpërmjet procesit të akreditimit. Për shkollat e larta ushtarake ose të policisë këtë të drejtë e ushtron ministri përkatës.

Hapja e departamenteve dhe e seksioneve bëhet me vendimin e senatit të shkollës së lartë, pasi të jetë marrë miratimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për plotësimin e stadardeve të vendosura prej saj. Efektet ekonomike të hapjes së tyre përballohen nga shkolla e lartë. Shteti, në buxhetin që i cakton shkollës së lartë publike, merr parasysh ekzistencën e këtyre njësive të reja vetëm pas rezultatit të vlerësimit institucional dhe akreditimit të shkollës së lartë .

Këtyre kritereve i nënshtrohen edhe hapja e atyre strukturave e njësive të parashikuara në nenin 12, të cilat përballohen nga buxheti i shkollës së lartë.

Mbyllja e kurseve të studimit, e departamenteve dhe e seksioneve bëhet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, pasi është dhënë vlerësimi nga Këshilli i Akreditimit.

Hapja e shkollave të larta universitare, shkollave të larta jouniversitare, fakulteteve, strukturave e njësive të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, të cilat nuk mund të përballohen nga fondi i shkollës së lartë , bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, ose të ministrive përkatëse për shkollat e larta ushtarake ose të policisë.

Mbyllja e institucioneve publike të përcaktuara në nenin 13 paragrafi 7 të këtij ligji, bashkimi i tyre, ndryshimi i misionit etj., bëhet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin

e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës ose të ministrive përkatëse për shkollat e larta ushtarake ose të policisë, pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit të Akreditimit.

Kriteret, mënyra e funksionimit dhe procedurat për dhënien e lejes për hapjen e shkollave të larta jopublike përcaktohen me këtë ligj dhe me akte nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave për zbatimin e tij. Leja për hapjen e një shkolle të lartë jopublike jepet jo më parë se 6 muaj pas datës së depozitimit të kërkesës në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës dhe jo më vonë se një vit nga data e depozitimit të saj në këtë ministri.

Në shkollat e larta ushtarake ose të policisë, kursi i studimit hapet me miratimin e ministrisë përkatëse. Përcaktimi i strukturës mësimore dhe organike të çdo shkolle të tillë bëhet në varësi të arsimit që jepet dhe miratohet nga titullari i ministrisë përkatëse.

Neni 14

Në sistemin e arsimit të lartë funksionon Konferenca e Rektorëve, si organ kolegjal autonom i rektorëve dhe i drejtorëve të shkollave të larta. Anëtar i Konferencës së Rektorëve është edhe një përfaqësues i autorizuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Konferenca e Rektorëve diskuton për problemet themelore të arsimit të lartë. Detyrat dhe kompetencat e Konferencës së Rektorëve burojnë nga ky ligj, si dhe nga statutet dhe rregulloret e brendshme të shkollave të larta. Organizimi dhe veprimtaria e Konferencës së Rektorëve përcaktohen në statutin e saj të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 15

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Senatet dhe këshillat në shkollat e larta janë organe kolegiale, të zgjedhura, që vendosin për problemet më të rëndësishme të shkollës së lartë në fushën e mësimi, kërkimit shkencor dhe në atë administrativo-financiare. Këto organe mbledhen periodikisht.

Senati është organi më i lartë i shkollës së lartë universitare; këshilli i fakultetit është organi më i lartë i fakultetit; këshilli i shkollës është organi më i lartë i shkollës së lartë jouniversitare dhe këshilli i departamentit është organi më i lartë i departamentit.

Këshilli drejtues është organi më i lartë kolegjal i shkollës së lartë ushtarake.

Përbërja, detyrat, kompetencat dhe funksionimi i senateve dhe i këshillave përkatëse përcaktohen në statutet e shkollave të larta dhe në rregulloret e tyre të brendshme.

Neni 16

Autoritetet drejtuese të shkollave të larta dhe të strukturave të njësive të tyre përbërëse janë:

- a) Rektori për shkollën universitare.
- b) Drejtori për shkollën jouniversitare.
- c) Dekani për fakultetin.
- ç) Përgjegjësi për departamentin.

d) Për shkollat e larta ushtarake ose të policisë, autoriteti drejtues, i barazvlefshëm me rektorin, drejtorin apo dekanin mund të jetë komandanti apo drejtori.

Në rast mungese, autoritetet ia delegojnë të gjitha kompetencat ose një pjesë të kompetencave zëvendësve të tyre.

Detyrat dhe kompetencat e këtyre autoriteteve drejtuese burojnë nga ky ligj dhe përcaktohen me hollësi në statutet e shkollave të larta.

Neni 17

(Ndryshuar paragrafi i tretë, i katërt dhe i pestë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Shkolla e lartë publike zgjedh organet dhe autoritetet e veta drejtuese.

Departamenti zgjedh, me shumicë votash, përgjegjësin e departamentit, anëtarë të këshillit të departamentit si dhe përfaqësuesit për në këshillin e fakultetit ose të shkollës së lartë jouniversitare.

Këshilli i fakultetit ose i shkollës së lartë jouniversitare përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga departamentet, nga personeli joakademik dhe nga studentët. Këshilli i fakultetit ose i shkollës së lartë jouniversitare (në rastin kur shkolla jouniversitare është strukturë e universitetit) zgjedh, me shumicë votash, përfaqësuesit e vet në senatin e shkollës së lartë universitare.

Senati i shkollës së lartë universitare përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur nga këshillat e fakulteteve e të shkollave të larta jouniversitare dhe nga studentët.

Dekani i fakultetit zgjidhet nga personeli akademik i brendshëm, nga përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët e këtij fakulteti.

Rektori i shkollës së lartë universitare ose drejtori i shkollës së lartë jouniversitare zgjidhet nga personeli akademik i brendshëm, nga përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët. Përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli joakademik dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga studentët, që votojnë për zgjedhjen e rektorit, janë po ata që votojnë për zgjedhjen e dekanit.

Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë. Procedurat dhe kriteret për pjesëmarrje në zgjedhjet e të gjitha kategorive të punonjësve të shkollave të larta dhe të studentëve përcaktohen në rregulloren për zgjedhjet në shkollat e larta, që miratohet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës. Kjo rregullore, dita e fillimit të zgjedhjeve dhe afatet e realizimit të tyre, në të gjitha shkollat e larta, shpallen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

Pas mbarimit të zgjedhjeve, Presidenti i Republikës emëron rektorin ose drejtorin e zgjedhur (në rastin kur shkolla jouniversitare është jashtë strukturës së Universitetit). Zëvendësrektori dhe zëvendësdrejtori propozohen, përkatësisht, nga rektori ose drejtori dhe emërohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Rektori emëron dekanin e zgjedhur dhe zëvendësdekanin e përzgjedhur nga dekani. Përgjegjësi i zgjedhur i departamentit emërohet nga dekani.

Neni 18

Rektori është njëkohësisht kryetar i senatit, drejtori është kryetar i këshillit të shkollës së lartë jouniversitare dhe dekani është kryetar i këshillit të fakultetit.

Përgjegjësi i departamentit në shkollën e lartë publike ka të drejtën e përzgjedhjes së përgjegjësve të seksioneve, mbi bazën e konkurimit me dosjen personale. Emërimi i përgjegjësit të seksionit bëhet nga dekani. Përgjegjësit e seksioneve, anëtarët e zgjedhur të

këshillit të departamentit së bashku me përgjegjësën e departamentit, përbëjnë këshillin e departamentit. Përgjegjësi i departamentit është kryetar i këshillit të departamentit.

Neni 19

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Autoritetet drejtuese të shkollave të larta publike zgjidhen çdo katër vjet. Ata nuk mund të zgjidhen radhazi në të njëjtin funksion më shumë së dy herë.

Senati dhe këshillat zgjidhen çdo tre vjet.

Neni 20

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Autoritetet drejtuese të shkollave të larta duhet të kenë gradë dhe tituj shkencorë. Në statutin e secilës prej shkollave të larta përcaktohen grada dhe titujt që duhet të kenë autoritetet sipas nenit 16, si dhe anëtarët akademikë të këshillave dhe të senatit.

KREU III

MARRËDHËNIET FINANCIARE DHE ADMINISTRATIVE

Neni 21

Shkollat e larta publike janë institucione buxhetore. Ato financohen nga buxheti i shtetit sipas ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe sipas akteve nënligjore në zbatim të tij. Buxheti i çdo shkolle të lartë është zë më vete në buxhetin për arsimin.

Fakultetet, në rastin kur plotësojnë standardet e caktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave, kanë llogari më vete.

Neni 22

Shkolla e lartë e detajon buxhetin sipas rektoratit, fakulteteve, departamenteve ose njësive të tjera të përcaktuara në nenin 12. Të gjitha këto njësi janë autonome në administrimin e këtij buxheti, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Për të gjitha njësitë, veprimet e llogarisë kryhen nëpërmjet administratës së shkollës së lartë, përveç rasteve kur njësitë kanë llogari më vete.

Neni 23

Fondet për kërkimin shkencor përcaktohen si zë më vete në buxhetin e çdo shkolle të lartë. Këto fonde administrohen nga shkolla e lartë në formë pagese për normën shkencore, si dhe për pajisjen e laboratorëve apo për shpenzime të tjera të lidhura me veprimtarinë shkencore.

Neni 24

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Shkollat e larta, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, krijojnë dhe përdorin të ardhurat që realizojnë gjatë veprimtarisë së tyre.

Tarifat e shkollimit për shkollat e larta publike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe përdoren nga shkollat e larta, pasi shlyhen detyrimet ndaj shtetit në masën jo më shumë se 10 për qind.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës kryen kontrollin dhe revizionin ekonomiko-financiar të shkollave të larta publike, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Arsimimi në shkollat e larta ushtarake ose të policisë është falas.

Arsimimi i ushtarakëve dhe i punonjësve të Policisë së Shtetit në shkollat e larta civile, në sistemin e shkollimit, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, është pjesë e arsimit të tyre të plotë, që kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji. Shpenzimet për këtë arsimim përballohen nga Ministria e Mbrojtjes për ushtarakët dhe nga Ministria e Rendit Publik për punonjësit e Policisë së Shtetit.

Neni 25

Ministria e Arsimit dhe Shkencës miraton strukturën orientuese të administratës së shkollave të larta në të gjitha nivelet.

Personat përgjegjës për mbarrëvajtjen administrative dhe ekonomike të shkollës së lartë janë kancelari i shkollës së lartë dhe kancelarët e fakulteteve, të cilët janë specialistë me formim të lartë ekonomik dhe me përvojë menaxhuese.

Kancelari i shkollës së lartë publike universitare apo jouniversitare propozohet, përkatësisht, nga rektori ose drejtori dhe emërohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Kancelari i fakultetit propozohet nga dekani dhe emërohet nga rektori.

Detyrat dhe kompetencat e kancelarëve përcaktohen në statutin e shkollës së lartë.

KREU IV PERSONELI I SHKOLLAVE TË LARTA

Neni 26

Personeli i shkollave të larta përbëhet nga:

- a) personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm;
- b) personeli ndihmës mësimor-shkencor;
- c) personeli administrativ;
- ç) personeli bibliotekar;
- d) personeli i shërbimit.

Detyrat dhe të drejtat e personelit të shkollave të larta, që burojnë nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen në statutin e shkollës së lartë dhe në rregulloren e brendshme të njësive përbërëse të shkollës, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 27

Komisioni i Kualifikimit Shkencor, i ngritur nga Këshilli i Ministrave, miraton klasifikimin për personelin akademik në shkollat e larta.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës vendos për numrin e vendeve të punës për personelin akademik, si dhe për klasifikimin dhe numrin e vendeve të punës për personelin administrativ, bibliotekar dhe të shërbimit të shkollave të larta publike civile. Për shkollat e larta ushtarake ose të Policisë vendosin ministratë përkatëse.

Vendet e punës për punonjësit e brendshëm akademikë, personelin ndihmës mësimor-shkencor, personelin administrativ dhe atë bibliotekar fitohen me konkurs dhe mbi bazën e kontratës së punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutet e shkollave të larta dhe rregulloret e veçanta të tyre.

Neni 28

Në shkollën e lartë publike personeli akademik i brendshëm është i detyruar të shërbejë, duke qenë i zënë me punë të paktën deri në kufirin minimal të normës mësimor-shkencore vjetore. Në rastet kur ndërmjet shkollave të larta shqiptare, ndërmjet tyre dhe shkollave të larta të huaja ose institucioneve kërkimor-shkencore, vendase apo të huaja, nënshkruhen marrëveshje për shkëmbim personeli akademik, norma minimale mund të realizohet në më shumë se një institucion.

Normat mësimor-shkencore caktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Për të plotësuar nevojat e realizimit të procesit mësimor-shkencor, shkolla e lartë kërkon punonjës të jashtëm akademikë, me kontratë me afate të ndryshme. Mënyrat e trajtimit të punonjësve të jashtëm të shkollave të larta publike caktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Këshilli i Ministrave përcakton numrin e orëve mësimore të papaguara nga buxheti i shkollave të larta, që një punonjës i institucioneve shkencore, në varësinë e Akademisë së Shkencave, është i detyruar të kryejë në shkollat e larta. Kjo ngarkesë mësimore është pjesë përbërëse e detyrës funksionale për të cilën këta punonjës paguhën nga Akademia e Shkencave.

Kriteret e përzgjedhjes së këtyre specialistëve përcaktohen me një rregullore të përbashkët, të nxjerrë nga shkolla e lartë dhe Akademia e Shkencave.

Neni 29

Shkolla e lartë funksionon në bazë të këtij ligji, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, të statutit dhe rregulloreve të brendshme.

Statuti i shkollës së lartë hartohet, përkatësisht, nga senati i universitetit apo këshilli i shkollës së lartë dhe miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Statuti i shkollave të larta ushtarake ose të policisë miratohet nga ministri përkatës. Rregullorja e zgjedhjeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese hartohet nga senati ose këshilli i shkollës së lartë dhe miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Rregullorja e brendshme e fakultetit miratohet nga rektori. Rregullorja e brendshme e departamentit miratohet nga dekani i fakultetit ose drejtori i shkollës së lartë jouniversitare. Këto rregullore hartohen nga këshillat përkatës.

Në zbatim të këtij ligji, statutet e shkollave të larta paraqiten për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës jo më vonë se tre muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligj. Në qoftë se brenda një muaji nga data e paraqitjes për miratim, Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk shprehet mbi këtë statut, ai konsiderohet i miratuar.

Neni 30

Personeli akademik i shkollave të larta ka të drejtë që, çdo 7 vjet, të kualifikohet, specializohet ose të kryejë jashtë shtetit veprimtari akademike në fushën përkatëse, për një periudhë kohe deri në një vit.

Kjo kohë mund të realizohet si e tërë gjatë një viti akademik ose në periudha të shkëputura.

Kriteret e mësipërme nuk zbatohen në rastet e studimeve të plota pasuniversitare jashtë shtetit, të cilat realizohen në përputhje me planet e kualifikimit të miratuara nga këshilli i fakultetit, në bazë të propozimit të departamenteve përkatëse.

Në të gjitha rastet nënshkruhet një kontratë e posaçme me shkollën e lartë, sipas mënyrave që përcaktohen në statutin e saj.

KREU V STUDENTËT

Neni 31

(Ndryshuar paragrafi i parë, fjalë dhe fjali me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Pranimet në shkollat e larta publike bëhen me kuota të parashikuara. Kuotat për sistemin e studimeve me kohë të plotë ndahen në kuota kryesore dhe kuota dytësore. Kuotat kryesore të pranimi për sistemin e studimeve me kohë të plotë propozohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme kuotat përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Në përcaktimin e kuotave kryesore dhe kuotave për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme, Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr mendimin e shkollave të larta. Kuotat dytësore dhe kuotat e sistemit të studimit me kohë të pjesshme janë kuota, për të cilat zbatohen tarifa të veçanta shkollimi.

Kuotat kryesore të pranimi në shkollat e larta ushtarake ose të policisë, propozohen nga ministritë përkatëse dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Shkollat e larta ushtarake ose të policisë nuk pranojnë studentë me kuotë dytësore.

Kuotat dytësore mund të shkojnë deri në 10 për qind të kuotave kryesore. Përcaktimi i këtyre kuotave dhe i mënyrave të pranimi sipas tyre bëhen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, pasi të jetë marrë mendimi i shkollave të larta. Tarifat e shkollimit për kuotat dytësore dhe sistemin e studimeve me kohë të pjesshme caktohen bashkërisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave.

Pranimet në shkollën e lartë publike bëhen me konkurs. Kur numri i kandidatëve të regjistruar është më i vogël se kuota e parashikuar, pranimet bëhen pa konkurs. Mënyrat e organizimit të konkurseve të pranimi dhe vlerësimi i rezultateve përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pas këshillimit me Konferencën e Rektorëve.

Organizimi i konkurseve bëhet nga shkolla e lartë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Shkolla e lartë, në përfundim të konkursit, pranon studentët fitues sipas kuotave të miratuara.

Pranimi i studentëve të huaj në shkollat e larta publike të Republikës së Shqipërisë

bëhet në bazë të kuotave që miraton Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Kriteret e pranimit përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 32

(Shtuar paragrafë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Studenti njihet i tillë me regjistrimin në shkollën e lartë dhe e humbet emrin student me marrjen e diplomës ose të dëshmisë ose me përjashtimin nga shkolla e lartë. Të drejtat dhe detyrimet e studentit përcaktohen në statutin e shkollës së lartë, në të cilën bën pjesë.

Studentët kanë të drejtë:

a) të përdorin të gjitha instalimet dhe pajisjet e shkollës së lartë për plotësimin e punës së tyre mësimore-shkencore, në përputhje me programet dhe rregullat përkatëse.

b) të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha këshillat e shkollës, duke përfshirë edhe senatin, në përputhje me mundësitë e përfaqësimit, të përcaktuara në statutin e shkollës së lartë.

c) të përfitojnë bursë studimi, kur përmbushin kushtet e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Studentët e shkëlqyer marrin bursë dhe shpërblime të veçanta, që administrohen nga shkolla e lartë. Bursat për studentët e shkëlqyer përballohen nga shteti, me fondet e veçanta që u jepen shkollave të larta, kurse shpërblimet përballohen nga vetë shkolla e lartë, nga të ardhurat që realizon ajo, në përputhje me nenin 24 të këtij ligji.

Studentët në çdo shkollë të lartë universitare zgjedhin qeverinë studentore.

Studentët pajisen me kartën e studentit.

Neni 33

Studentët e shkollave të larta kanë të drejtë të organizohen në shoqata studentore jopolitike.

Krijimi, organizimi, funksionimi dhe shpërndarja e shoqatave studentore në shkollat e larta bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Neni 34

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për kujdesin dhe ndihmën ndaj studentëve të shkollave të larta për ushtrimin e të drejtave dhe të detyrimeve të tyre, krijon një sektor të informacionit studentor.

KREU VI

STUDIMET NË SHKOLLAT E LARTA

Neni 35

(Ndryshuar paragrafi I parë me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Sistemi i studimeve në shkollën e lartë është me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme.

Kohëzgjatja e studimeve të plota në shkollat e larta universitare llogaritet në vite akademike dhe nuk është më pak se tre vjet.

Për shkollat e larta jouniversitare kjo kohëzgjatje nuk është më e vogël se dy vjet akademikë.

Kohëzgjatja e plotë e studimëve në shkollat e larta ushtarake ose të policisë është jo më pak se tre vjet akademikë. Për kandidatin që pranohet pas përfundimit të një shkollë të lartë civile, kjo kohëzgjatje është jo më pak se një vit akademik.

Neni 36

Shkollat e larta funksionojnë në bazë të planeve mësimore, që hartohen prej tyre dhe miratohen nga senati ose këshilli i shkollës së lartë.

Programet mësimore hartohen nga çdo lektor ose grup lektorësh, shqyrtohen në mbledhjen e seksionit ose të departamentit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.

Neni 37

Arsimimi pasuniversitar është hallkë e sistemit të arsimit të lartë dhe organizohet pranë shkollave të larta. Ai përfshin kualifikimin shkencor pasuniversitar, kurset e specializimit dhe kurset e kualifikimit afatshkurtër e afatgjatë.

Neni 38

(Ndryshuar togfjalësh dhe shtuar paragraf me ligjin nr. 9120, datë 28.7.2003)

Kualifikimi shkencor pasuniversitar realizon përgatitjen e specialistëve, të aftë për të kryer veprimtari kërkimore-shkencore. Kualifikimi shkencor pasuniversitar kryhet pranë shkollave të larta universitare dhe përfundon me dhënien e gradës “Doktor i shkencave”. Diplomë ndërmjetëse është “Master”.

“Master” jepet pas mbarimit me sukses të shkollës pasuniversitare. Hapja dhe mbyllja e shkollës pasuniversitare bëhet me të njëjtat procedura si ato të përcaktuara në nenin 13 (paragrafi i shtatë dhe i tetë) të këtij ligji.

Fondet për organizimin dhe funksionimin e shkollave pasuniversitare publike përballohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera financiare, sipas legjislacionit në fuqi.

Studimet për doktoraturë kryhen pranë shkollës së lartë universitare, ku është hapur shkolla pasuniversitare. Të drejtën për ndjekjen e këtyre studimeve e kanë vetëm personat që kanë marrë “Master” apo diploma të tjera, të huaja, të barazvlefshme me të.

Studimet për të marrë diplomën e shkollës pasuniversitare dhe për doktoraturë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kryhen në Akademinë e Mbrojtjes, ndërsa në fushën e rendit dhe të sigurisë publike kryhen në Akademinë e Policisë.

Personat që ndjekin shkollën pasuniversitare apo doktoraturën, gëzojnë të drejtat dhe u nënshtrohen detyrimeve të studentëve, të përcaktuara në kreun V të këtij ligji, si dhe në statutin dhe rregulloret e brendshme të shkollës së lartë universitare përkatëse.

Neni 39

Kurset e specializimit dhe të kualifikimit afatshkurtër e afatgjatë hapen pranë shkollave të larta, në përputhje me kriteret e paracaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 40

Ministria e Arsimit dhe Shkencës kryen kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në shkollat e larta.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të shfuqizojë çdo akt të nxjerrë nga senati i shkollës së lartë universitare, nga këshilli i shkollës së lartë jouniversitare, rektori ose drejtori i tyre, në rastet kur këto akte janë në kundërshtim me ligjin.

Rektori shfuqizon vendimet e dekanit apo të këshillit të fakultetit, kur këto bien ndesh me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e konflikteve ndërmjet tyre çështja ankimohet në gjykatën e apelit.

Në raste flagrante, kur me veprimet e tyre rektori apo drejtori shkelin, në mënyrë të përsëritur, aktet ligjore, nënligjore, statutin apo rregulloren e shkollës së lartë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës thërret zgjedhjet e parakohshme për rektorin apo drejtorin e ri, pasi merr paraprakisht mendimin e senatit. Në raste të tilla të njëjta, rektori thërret zgjedhjet e parakohshme për dekanin apo drejtorin e ri, kurse dekanin apo drejtorin thërret zgjedhjet e parakohshme për përgjegjësin e ri të departamentit, pasi merr paraprakisht mendimin e këshillave përkatës.

Neni 41

Çdo shkollë e lartë harton projektstatutin e vet, në përputhje me këtë ligj dhe me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, e cila kujdeset për harmonizimin e këtyre projektstatuteve mbi një trung të përbashkët, duke pasur parasysh edhe specifikat e çdo shkolle të lartë.

Neni 42

Shtetasve të Republikës së Shqipërisë, kur plotësojnë kushtet për të ndjekur studimet e larta, u njihet e drejta të studiojnë e të diplomohen në më shumë se një fushë studimi pranë shkollave të larta. Këto të drejta realizohen në përputhje me kriteret e paracaktuara në statutet e shkollave të larta.

Neni 43

Mënyrat e njohjes dhe të ekuivalentimit të certifikatave, diplomave dhe gradave të fituara në shkolla të larta të huaja bëhen me akte të Këshillit të Ministrave, duke respektuar marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Neni 44

Çdo shkollë e lartë ka të drejtë të zgjedhë emrin zyrtar dhe stemën e vet.

Emri zyrtar dhe stema e shkollës së lartë, të zgjedhura nga shkolla e lartë, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës ose Ministrisë së Mbrojtjes ose të Ministrisë së Rendit Publik, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 45

Ligji nr.7810, datë 6.4.1994 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet e tij, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe aktet nënligjore, që lidhen me arsimin e lartë e që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 46

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2331, datë 8.3.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani